

URDHËR
Nr. 442, datë 29.7.2019

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT,
LIQENI ULËZ-SHKOPET 2019–2029

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, neni 55, pika 2, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të peshkimit për liqenin e Ulzës dhe Shkopetit, për periudhën 2019–2029.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, liqeni Ulzë dhe Shkopet. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi